



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 496/P/ Prot. Q-19

Tiranë, më 07/10/2021

URDHËR

Nr. 55P, Datë 07.10.2021

**“PËR
MARRJEN NË DORËZIM TË AKTEVE NOTERIALE, REGJISTRAVE TË ISH-
NOTERES VIOLETA ISARAJ”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7, të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, Urdhrit nr. 168 datë 10.06.2020 “Për evidentimin dhe marrjen në dorëzim të arkivave të padorëzuara ndër vite”, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 3383 datë 29.05.2007 “Për Heqjen e Licencës së Ushtrimit të profesionit të noterit Violeta Isaraj”,

KONSTATOJ :

Pranë Ministrisë së Drejtësisë është administruar kërkesa e shtetasit Qemal Allkurti protokolluar me nr. Q-19 Prot., datë 20.08.2021, përmes së cilës kërkon informacion mbi arkivën noteriale të ish-noteres, të ndjerës Violeta Isaraj, pasi kërkon të pajiset me kopje të akteve noteriale që janë hartuar prej saj.

Nga verifikimi kryer, lidhur me arkivën noteriale të ish-noteres Violeta Isaraj nuk rezulton që nga ana e komisionit përcaktuar në pikën 2, të Urdhrit nr. 3383 datë 29.05.2007, të Ministrit të Drejtësisë, të jenë marrë masa për marrjen e kësaj arkive dhe asgjësimin e vulave të ish-noteres.

Në këto kushte, lind nevoja për ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të regjistrave dhe akteve noteriale, të ish noteres Violeta Isaraj, me qëllim mbarëvajtjen e punës dhe mospengimin e shtetasve për pajisjen me akte noteriale të cilat ndodhen në arkivën e ish noteres, si dhe asgjësimin e vulës së thatë dhe të njomë të ish-noteres.

Për sa më sipër, bazuar në Ligjin nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për noterinë”, si dhe Urdhrit nr. 168 datë 10.06.2020 “Për evidentimin dhe Marrjen në dorëzim të arkivave të padorëzuara ndër vite”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të arkivës noteriale të ish noteres Violeta Isaraj, i përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

- a) Znj. Ina Papa Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira, në Ministrinë e Drejtësisë;
- b) Noteri z. Lorenc Daka përfaqësues i Degës Vendore të Noterisë Tiranë;
- c) Noterja znj. Enkelejda Hoxha përfaqësuese Dhomës Kombëtare të Noterisë.

2. Komisioni për marrjen në dorëzim të arkivës merr në dorëzim me procesverbal të nënshkruar nga të gjithë antarët dhe personat të cilët kanë në ngarkim, regjistrat, aktet noteriale të arkivit të noterit dhe vulat përkatëse.

3. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, anëtarët e komisionit të caktuar në pikën 1, të këtij urdhri, të verifikojnë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojnë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.

4. Arkiva t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noterit, të Degës Vendore të Noterisë Tiranë z. Erjon Bardhi, pas verifikimit nga ana e antarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të arkivit, se noteri plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryerjen sa më të shpejtë e cilësor të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

5. Komisioni i ngritur në zbatim të këtij urdhri kryen dorëzimin e regjistrave dhe akteve noterial noterit z. Erjon Bardhi, të caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Tiranë, si dhe kryen asgjësimin e vulës së thatë dhe vulës së njomë, të ish-noteres Violeta Isaraj.

7. Ngarkohet Sektori Arkiv – Protokollit për njoftimin e këtij urdhri antarëve të komisionit të caktuar në pikën 1 të tij, Dhomës Kombëtare të Noterisë, Degës Vendore të Noterisë Tiranë, si dhe personave të cilët kanë në ngarkim arkivën e padorëzuar të ish-noteres Violeta Isaraj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ulsi Manja

